

Raport për rezultatet e konsultimeve publike për:

projektligjin, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar””

1. Titulli i projekt aktit

“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar””.

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar, ka si qëllim forcimin e rolit të prefektit të qarkut, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në territor, përfshirjen e tij aktive në koordinimin dhe ndërlidhjen e veprimtarisë së organeve qendrore në kuadër të ushtrimit të detyrave dhe kompetencave të tyre në nivel vendor. Prefekti i qarkut merr një rol gjithëpërfshirës edhe për bashkërendimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore mbi problematikat në lidhje me emergjencat civile.

Me ndryshimet e propozuara, forcohet roli i Prefektit të Qarkut edhe në Këshillat Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillin Kombëtar të Sigurisë në Komunitet, përmes bashkërendimit dhe koordinimit me përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes, si dhe institucioneve në nivel qendror.

Projektligji ka si objektiv përmirësimin e bashkëpunimit midis Prefektit të qarkut, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, me qëllim rritjen e sigurisë publike dhe qetësisë në komunitet.

Për përmbushjen e qëllimit dhe objektivave del e nevojshme krijimi i një strukture të re, konkretisht “Prefekti Detar”, për forcimin e qeverisjes, sigurisë dhe koordinimit në zonat bregdetare. Rritja e zhvillimeve turistike, aktiviteteve detare, rreziqet mjedisore bëjnë të domosdoshme ngritjen e një strukture të specializuar që garanton zbatimin e politikave shtetërore në nivel vendor për zonat bregdetare.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Publikimi në RENJK i këtij projekt akti u bë në datë 18.12.2025 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJKP, të gjitha palët e interesuara:

- organet publike;
- shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;
- personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe
- personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë,

ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projekt aktin.

Projekt akti u konsultua së bashku me dokumentacionin shoqërues në RENJKP, duke qëndruar i publikuar prej datës 18.12.2025 deri në datë 20.1.2026, duke marrë 678 shikime dhe 0 komente.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar””, është si më poshtë:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit. Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Nuk rezulton të ketë patur palë të interesuara (organizata të shoqërisë civile, subjekte private apo individë), të përfshira në procesin e konsultimit publik të projekt aktit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Nuk pati komente apo sugjerime lidhur me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar”, të publikuar në RENJK.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi	Justifikimi
(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	(grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	(Pranuar/Pranuar pjesërisht/Refuzuar)	